

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPEERTIT SHQYRTUES

<i>Emri dhe Mbiemri i ekspertit Shqyrtues dhe nënshkrimi</i> Daut Retkoceri	<i>Data e autorizimit të Ekspertit</i> 25.12.2020	<i>Data e dorëzimit të raportit</i> 06.01.2021	<i>Nr. i lëndës:</i> 1130/20
--	--	---	---------------------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 22.12.2020, Grupi i Operatorëve Ekonomik: N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K-Prizren, ka parashtruar ankesë me nr.:1130/20, pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren” me numër të prokurimit: 622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK – “KK-Prizren” kundër B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES e publikuara përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net me datën 16.10. 2020. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1.300. 000,00€ - e përsëritur

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETËNDIMET ANKIMORE te Grupit te OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K-Prizren

Dispozitat e shkelura dhe pikat e ankesës.

1. Neni 12 -- LPP-së
2. Neni 69 -LPP-sE

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me datën 16.10.2020 AK ka publikuar "B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK-1" përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net. Ku si fitues të propozuar për kontratë është shpallur Operatori Ekonomik "ALBOSS" SH.P.K.

Pretendimi 1

1. Dyshojmë se ne kontratat e O.E. ALBOSS SH.P.K. dhe KFOR –it perkatesishte kontratat
 - a. IFB-TACO-KFOR-19-103 IMPROVEMENT OF APOD MAIN GATE
 - b. IFB-TACO-KFOR-19—09319-093 REFURBISHMENT OF WORKDS FOR FLOOD DAMAGE MITITGATION IN MILAPOD
 - c. IFB-TACO-KFOR-19-094 REFURBISHMENT & REORGANISING OF MAN GATE AT CNHDyshojmë se ne këto kontrata është falsifikuar nënshkrimi i personit përgjegjës se KFOR-it konkretisht Znj.

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën 1130/20 e parashtruar nga: Grupi i OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K& “Renelual Tahiri” SH.P.K-Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren” me numër të prokurimit:622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK– “KK-Prizren” e përsëritur

REGINE DOUGLAS ku ne te gjitha kontratat nënshkrimi i saj është i përmasave identike pa dallim fare. Ne e kemi bere krahasimin me matje te sakta te nënshkrimit si dhe ne baze te dukjes vizuale ku nënshkrimin e Znj. DOUGLAS e kemi përshkallëzuar ne përmasën e njëjtë ku dhe e kemi vërejtur përputhshmërinë e te gjitha nënshkrimeve ne te gjitha këto kontrata ku ka rezultuar plotësisht identik.

Ne kontratën e pare IFB-TACO-KFOR-19-103 IMPROVEMENT OF APOD MAIN GATE, ne faqen ku është nënshkruar nga Znj. DOUGLAS dhe personi përgjegjës i operatorit ekonomik z.Avni Kurtishaj e përkatësisht nen hapësirën e nënshkrimit te znj. DOUGLAS tek vija e supozuar ku duhet te nënshkruhet vërehet një ndërprerje apo fshirje e vijës qe nuk mund te jete e rastësishme sepse ky detaj është paraqitur ne te gjitha kontratat e lartcekura. Nëse e shikojmë fjalinë menjëherë poshtë rubrikës ku kane nënshkruhet thuhet :


"THE VALIDITY OF THIS CONTRACT WILL BE CONTINGENT UPON THE SIGNATURE OF THE FINANCIAL CONTROLLER", qe po ta përkthejmë ne gjuhen Shqipe, datë thotë : Vlefshmëria e kësaj kontrate do te jete kontingjente pas nënshkrimit te kontrolluesit financiar, i cili ne ketë rast eshte Z.SPYRAKIS KONSTANINOS, mirëpo nënshkrimi i këtij te fundit mungon.

Po ashtu ne kontratën e pare te lartcekur konkretisht ne faqen e fundit te kësaj kontrate vërehen disa detaje dyshuese si ne datat e nënshkrimit te kontratës ku tek nënshkrimi i kontrolluesit financiar Z. Spyrakis Konstantinos ka datën 04/11/19, te nënshkrimi Znj. REGINE DOUGLAS ka datën 31/10/19 dhe te nënshkrimi i përgjegjësit nga operatori ekonomik ka datën 25/11/2019. Parashtrohet pyetja si ka mundësi qe kontratës i jepet validiteti nga kontrolluesi financiar para se te nënshkruhet nga Znj. Douglas dhe përgjegjësi i operatorit ekonomik? Dhe si ka mundësi qe ne kontratë dallimi nga nënshkruesja Znj. Douglas dhe përgjegjësi i operatorit ekonomik ka pothuajse një muaj? Dhe si ka mundësi qe ne te gjitha kontratat e lartcekura nuk ka vule nga KFOR-i?



Po ashtu ne kontratën IFB-TACO-KFOR-19-103 IMPROVEMENT OF APOD MAIN GATE ne faqen e dyte ne rubrikën 6. Thuhet kuart qe kontrata do te jete efektive pas nënshkrimit te fundit ku te dy palët janë ne dijeni dhe pranojnë kushtet e kontratës. Atëherë si ka mundësi qe Znj. DOUGLAS ka nënshkruar me date 16 Gushte 2019 kurse Z. Avni Kurtishaj ka nënshkruar me datën 25.11.2019?



Gjithashtu kemi vërejtur se kontratat BU 1708/B "Sanimi i fasadës ne objektin e shtabit DEU EinsKtgt Kfor" ka vulën identike me kontratën "BU1712 Kos PRZ (Sanimi I një ndërtese te rojës tek porta 2 e kampit ushtarak Camp Prizren". Derisa kontratat e tjera te cilat janë me KFOR nuk kanë vula.



Si përfundim ajo qe na bën te dyshojmë është falsifikimi apo keqpërdorimi i nënshkrimit te Znj. Regine Douglas ku ne te gjitha kontratat e lartcekura nënshkrimi është identik thjeshte ka ndryshime te vogla ne Madhësi. Nëse te gjitha nënshkrimet e Znj. Regine Douglas i marrim dhe i vendosim ne përpjesë te njëjtë rezulton te jete identik pa asnjë ndryshim sado te vogël. Pastaj janë datat e nënshkrimeve te cilat nuk korrespondojnë. Si dhe ka raste ku nënshkrimi i Znj. Regine Douglas është firmos me stilolaps me ngjyre te zeze ku prapë rezulton identik me nënshkrimet e vendosura ne kontratat tjera. Po ashtu nuk ka vule te vendosur ne asnjërën prej këtyre kontratave.





Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën 1130/20 e parashtruar nga: Grupi i OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K-Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit:622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK- "KK-Prizren" e përsëritur

 REGINE DOUGLAS, OR-S, USA F Chief, Regional Allied Contracting Office	 Name: <u>ALAN KONTISTAKIS</u> Position: <u>GENERAL DIRECTOR</u>
THE VALIDITY OF THIS CONTRACT WILL BE CONTINGENT UPON THE SIGNATURE OF THE FINANCIAL CONTROLLER	
SPYRAKIS KONSTANTINOS, A-S, CIV G Chief JR, Financial Controller	Date: _____
Date: 23 July 2019 KFOR	Date: 25 July 2019 CONTRACTOR

 REGINE DOUGLAS, OR-S, USA F Chief, Regional Allied Contracting Office	 Name: <u>ALAN KONTISTAKIS</u> Position: <u>TECHNICAL DIRECTOR</u>
THE VALIDITY OF THIS CONTRACT WILL BE CONTINGENT UPON THE SIGNATURE OF THE FINANCIAL CONTROLLER	
SPYRAKIS KONSTANTINOS, A-S, CIV G Chief JR, Financial Controller	Date: _____
Date: 23 July 2019 KFOR	Date: 25 July 2019 CONTRACTOR

 REGINE DOUGLAS, OR-S, USA F Chief, Regional Allied Contracting Office	 Name: <u>ALAN KONTISTAKIS</u> Position: <u>TECHNICAL DIRECTOR</u>
THE VALIDITY OF THIS CONTRACT WILL BE CONTINGENT UPON THE SIGNATURE OF THE FINANCIAL CONTROLLER	
SPYRAKIS KONSTANTINOS, A-S, CIV G Chief JR, Financial Controller	Date: _____

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën 1130/20 e parashtruar nga: Grupi i OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K-Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit: 622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK- "KK-Prizren" e përsëritur

Me te gjitha këto faktet e paraqitura me larte është i njoftuar edhe udhëheqësi I sektorit te prokurimit ne Prizren Isa Osmankaj, mirëpo nuk është ndërmarrë asgjë,

Pretendimi 2

1. Nuk është respektuar Neni 12 pika 1 dhe 2 e LPP-së Neni 12 Valutat, Pagesat dhe Kushtet e Zakonshme të Kontratës 1. Të gjitha çmimet dhe vlerat e specifikuara në çfarëdo kontrate publike, dosje të tenderit, njoftim, ftesë për tender ose pjesëmarrje, duhet të deklarohen dhe t gjitha pagesat e tyre duhet të bëhen në Euro. 2. Kushtet dhe termet e kontratave publike duhet të jenë në përputhje me praktikrat e zakonshme publike dhe afariste për llojin dhe lëndën e veçantë të kontratës përkatëse.

Ne Pramasten e ofruar nga OE"ALBOSS" SH.P.K tek rekapitullimi i punimeve te mbindërtimit OE ne fjale e përdorë simbolin e valutës \$,

Pretendimi 3

2. Nuk është respektuar Neni 69 e LPP-së Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Nuk e plotëson Kërkesën 1. "Projektet e natyrës së kontratës të realizuar ne tri vite te shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) vlera minimale e ti gjitha projekteve te natyrës së Kontratës duhet te jetë jo me vogël se 1.900.000 €"

OE në fjalë arrin një total të kontratave me vlerë: "1.591,187.39€" Kjo pasi qe disa nga kontratat nuk janë fë natyrës së njëjtë:

- 1.Ndërtimi i Terenit sportive ne Lagjen 11 Marsi ne Prizren, me nr të prokurimit 622-18• 096-521. - 119,567.70€
- 2.Krijimi i ambientit ne Kabash dhe Korish si destinacion turistik, me nr të prokurimit 622-18-117-521. - 71,087.00€
3. Demolimi i sipërfaqes Charlie ne kampin fushor Prizren. - 444,695.00€

Ndërsa tek Lista e Kontratave, Kontratat me numër 30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43. Janë me te vjetra se 3 vite

Pretendimi 4

Për Grupin e Operatorëve Ekonomik t tjerë Autoriteti Kontraktues ka zbatuar ligjin e prokurimit dhe rregulloren duke u mbështetur në nenet dhe në dokumentet qe Ata si OE nuk i plotësojnë kushtet dhe nuk janë të përgjegjshëm për realizimin e projektit. Për OE - CONSTRUMAX SH.P.K., Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh, 23000, Suharekë

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye : Ju mungojnë: I. Certifikim OHS4S 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë

Ne si OE pajtohemi me vendimin e AK ne lidhje me OE - CONSTRUMAX SH.P.K. AK duke respektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht, Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te Rroupp-së.

PER Grupin i OE Grup i Operatorëve Ekonomik B Ademaj SH.P.K.; MBB Construction SH.P.K.; N.T.P.'GRESA - COMMERCE ", zhur Prizren, -20520, ZHUR pn mungojnë:

1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se

1.900.000,00 €.

2 .të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të nga 5 10 ton (pesha bartëse).

b. Kran për bartjen e peshave në lartësi.

c. skele të mjaftueshme për ndërtim dhe suvatim të jashtëm të objektit. (Ju mungon një kamion 5 -10 to -pesha bartëse).

3.Certifikim OHS4S 18001 per Shëndetin dhe Sigurinë në Punë. AK duke respektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht, Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te RROUPP-së.

Ne si OE pajtohem me vendimin e AK ne lidhje me GOE-B Ademaj SH.P.K.; MBB Construction SH.P.K.; N.T.P.'GRESA - COMMERCE "AK duke respektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht, Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te RROUPP-së

Per Grupin i OE Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.T Loni ; V- SHALA SH.P.K. , ADEM JASHARI 169 , PEJE mungojnë;

1. të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton (pesha bartëse). b. Kran për bartjen e peshave në lartësi. c. skele të mjaftueshme për ndërtim dhe suvatim të jashtëm te objektit. (Ju mungojnë 2 kamion 5 -10 ton -pesha bartëse).

Ne si OE pajtohem me vendimin e AK ne lidhje me GOE -.P.T. Loni ; V-SHALA SH.P.K."AK duke respektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht, Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te RROUPP-së

Per Grupin i OE Grup i Operatorëve Ekonomik EdiBau- ing SH.P.K.; N.P.T. Bamirs, UKë BYTYCI PN, 20000, PRIZREN mungojnë:

1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.900.000,00 €.

Vërejtje : EdiBahu -Ing ka referenca ne vlerën 664.206,36 € < 60 % Bamirs- a qarkullim ne vlerën 98644,00 € <40 %,

2. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjate tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 2.600.000,00 €.

Vërejtje: EdiBahu -Ing ka qarkullim ne vlerën 1.460.037.30 € < 60 %, Bamirs- ka qarkullim ne vlerën 0.00 € < 40 %,

3. të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton (pesha bartëse). b. Kran për bartjen e peshave në lartësi. c. skele të mjaftueshme për ndërtim dhe suvatim tjashtëm të objektit. (Ju mungojnë I kamion 5 -10 ton -pesha bartëse).

Ne si OE pajtohem me vendimin e AK ne lidhje me GOE-. EdiBau- ing SH.P.K.; N.P.T. Bamirs.'AK duke rrespektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te RROUPP-së

Per Grupin i OE Grup i Operatorëve Ekonomik HIDRO PROJECT SH.P.K.; A. Krasniqi B.I. N.N.SH.; WORLD MEDIUM, Bill Clinton,14-1, -, PRISHTINË mungojnë :

1. projektet e natyrës s kontratës realizuar e ri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij

njoftimi) e vërtetuar nga OE , ku përfshihen titujt e projekteve , numri, data e kontraktimit te standarde dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.900.000,00 €.

2. të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton (pesha bartëse). b. Kran për bartjen e peshave në lartësi. c. skele të mjaftueshme për ndërtim dhe suvatim të jashtëm të objektit. (Ju mungojnë 1 kamion 5 -10 ton -pesha bartëse).

Ne si OE pajtohem me vendimin e AK ne lidhje me GOE-. HIDRO PROJECT SH.P.K.; Isuf A. Krasniqi B.I.; N.N.SH. WORLD MEDIUM."AK duke rrespektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht, Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te Rroupp-së

Per a OE- Olti Trasing SH.P.K., Bill KTinton, I0000, PRISH'TINE,

. të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton (pesha bartëse). b. Kran për bartjen e peshave në lartësi. c. skele të mjaftueshme per ndërtim dhe suvatim të jashtëm të objektit. (Ju mungojnë 1 kamion 5 -10 ton -pesha bartëse).

Ne si OE pajtohem me vendimin e AK ne lidhje me OE -. "Olti Trasing " SH.P.K AK duke respektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te RROUPP-së

Per Grupin i Grup i Operatorëve NBT -ING SH.P.K.; " Konstruktori Ing.1969 Sh.p.k., Brigada 123 p.n, 23000, SHIROKë, mungojnë

Gjithashtu kërkojmë nga OE qe ti ofroje Kontratat dhe Paramasat ne original te kontraktuara nga "Headquarters Kosovo Force -- KFOR

1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.900.000,00 €.
2. të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton (pesha bartëse). b. Kran për bartjen e peshave në lartësi. c. skele të mjaftueshme për ndërtim dhe suvatim të jashtëm të objektit.

Ne si OE pajtohem me vendimin e AK ne lidhje me GOE-. NBT -ING SH.P.K.;" Konstruktori Ing.1969 Sh.p.k" AK duke respektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te RROUPP-së

Per Grupin I OE -- Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.T. Etniku ; KAG- Asphalt Company SH.P.K., Samadrexhe, 23060, Suharekë, mungojnë:

1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit te standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet te jetë jo më e vogël se 1.900.000,00 €.
2. Në kuadër te stafit duhet te caktohet menaxheri i projektit I cili duhet te jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku nje projekte të natyrës së kontratës. b. Një inxhinier i diplomuar ose master i makinerisë me jo më pak se vite përvojë pune në profesion. c. Një inxhinier i diplomuar ose master i elektros me jo mpak se 3 vite përvojë

pune në profesion. d. Një inxhinier i diplomuar ose master i hidros me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. Vërejtje :

1. Idriz Seferaj - IDN nuk ka kontrate pune ose bashkëpunimi dhe vendim për menaxher për këtë projekt,
 2. Veton Kukaj- IDM nuk ka kontrate pune ose bashkëpunimi,
 3. Malush Muslija- IDE nuk ka kontrate pune ose bashkëpunimi,
 4. Donjeta Berisha- IDH nuk ka kontrate pune ose bashkëpunimi,
3. të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton (pesha bartëse). b. Kran për bartjen e peshave në lartësi. c. skele të mjaftueshme për ndërtim dhe suvatim të jashtëm të objektit. (Ju mungojnë I kamion 5 -10 to -pesha bartëse).

Ne si OE pajtohemi me vendimin e AK në lidhje me GOE -.N.N.T. Etniku ;KAG- Asphalt Company SH.P.K. "AK duke respektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 të LPP dhe Neni 39-të RROUPP-së

PROPOZIMJ JONE:

TE APROVOHET ankesa e OE "Alfa-Ing" N.P.N. si e bazuar.

TE ANUL OHET Njoftimi dhe Vendimi i AK-së për dhënie të kontratës

TE DETYROHET, autoriteti kontraktues që Rivlerësimi i ofertave të bëhet konform dispozitave të LPP-s& dhe kërkesave të FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

KRITËRET PËR VLERËSIM

PJESA A:PROCEDURAT E TENDERIMIT

Seksioni I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT

Të Përgjithshme

20. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit

20.1 Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara në tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.900.000,00

Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri I projektit I cili duhet të jetë inxhinier I diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion -Të ketë menaxhuar së paku një projekt të natyrës së kontratës. b.Një inxhinier i diplomuar ose master i makinerisë me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. c. Një inxhinier i diplomuar ose master i elektros me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. d. Një inxhinier i diplomuar ose master i hidros me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.

Kërkesa 3. Të ketë së paku 30 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës

Kërkesa 4. të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton (pesha bartëse). B Kran për bartjen e peshave në lartësi. c. skele të mjaftueshme për ndërtim dhe suvatim të jashtëm të objektit

Kërkesa 5. OE duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO 9001e vitit 2015 dhe ISO 14001 e vitit

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën 1130/20 e parashtruar nga: Grupi i OE N.P.N "Alfa-Ing" &"BM Group" SH.P.K& "Renelual Tahiri" SH.P.K-Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit:622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK- "KK-Prizren" e përsëritur

2015 Certifikim OHSAS 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësoj minimum 60 % të kërkesave ekonomiko financiare si dhe kritereve teknike profesionale Kran për bartjen e peshave në lartësi. c. skele të mjaftueshme për ndërtim dhe suvatim të jashtëm të objektit Kërkesa 5. OE duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO 9001e vitit 2015 dhe ISO 14001 e vitit 2015 Certifikim OHSAS 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësoj minimum 60 % të kërkesave ekonomiko financiare si dhe kritereve teknike profesionale

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 Lista e projekteve të natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosjen elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve.

Dëshmia 2 Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë . b.c.d. Dëshmi mbi kualifikimin e stafit profesional të kërkuar, dëshmi mbi përvojën, kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë Project.

Dëshmia 3. Lista e të punësuarve e paraqitur në ATK në tre muajt e fundit bashke me përshkrimi I shkurtër I vendit të punës për stafin ose kontratat e bashkëpunimit në të cilat duhet të ceket titulli i këtij projekti si dhe vlefshmëria së paku sa kohëzgjatja e realizimit të këtij projekti.

Dëshmia 4. a.b. pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë librezat të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhet të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre DUD ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve

Dëshmia 5. certifikatat ISO 9001e vitit 2015 dhe ISO 14001 e vitit 2015 Certifikim OHSAS 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Raporti i vlerësimit për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore

OE i përgjegjshëm me çmimin më të ultë

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPËRTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Kerkesë për plotësim të dokumentacionit të datës 31.12.2020

Të nderuar

OSHP-ja me ka autorizuar për shqyrtim të ankesës OSHP. PSH.Nr. 1130/20 nga Operatorët Ekonomik: Konzorciumi N.P.N "Alfa ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K- Prishtinë pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me nr të prok: 622-20-2658-5-1-1 iniciuar nga AK/ - "KK-Prizren", në cilësinë e ekspertit shqyrtues, kërkoj që brenda dy ditëve nga data e marrjes së kësaj kërkesë t'i publikon në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net> si dhe në adresën time elektronike dautretkoceri@gmail.com

1. Informatat për sqarimet shtese të kërkuara nga Operatorët ekonomik në baze të vendimit të OSHP-se nr. 880/20 dt. 25.11.2020
 - Kërkesë për plotësim të dokumentacionit
 - o E cila i është drejtuar operatorit ekonomik
 - o Datën e kërkesës
 - Dokumentacionin e pranuar sqarues
 - o Datën e pranimit

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën 1130/20 e parashtruar nga: Grupi i OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K- Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit: 622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK- "KK-Prizren" e përsëritur

- o Llojin e dokumentacionit

Te cilën e kam pranuar me datën 05.01.2021

Përsëritet nderuar. Me që edhe 20 minuta po përfundon orari i punës për ditën e sotme e zyrtares e cila ka të ruajtur këtë komunikim dhe përgjigje është në pushim vjetor, PËRGJIGJEN E KOMPLETUAR LIDHUR ME KËTË PROJEKT DO TA MERRNI DITËN E PARË TË PUNËS PËR VITIN 2021. QË I BI TË JETË 05. 01. 2021.

Urime festë dhe iu dëshiroj gjith të mirat në vitin 2021

Isa Osmankaj

Komuna e Prizrenit

From: Daut Retkoceri [mailto:dautretkoceri@gmail.com]

Sent: 2020-12-31 11:28.PD

To: Isa Osmankaj; OSHP; Blerim Dina; Ardian Behra; Labeot Kabashi; Shqipe Hoti

Subject: Kërkes

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

Grupit të OE ankues N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K-Prizren sipas nenit 4.1.26 të LPP-së janë palë me interes sepse Komisioni për vlerësimin e ofertave gjatë vlerësimit, ofertën e tij e ka shpallë të pasuksesshëm

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTËT E NGJASHME

Nuk ka

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Grupit të OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K

PRETENDIMI NR.1

Lidhur me pretendimin e Grupit të OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K – ankues Dyshojmë se në kontratat e O.E. ALBOSS SH.P.K. dhe KFOR –it përkatësisht kontratat:

- IFB-TACO-KFOR-19-103 IMPROVEMENT OF APOD MAIN GATE
- IFB-TACO-KFOR-19—09319-093 REFURBISHMENT OF WORKDS FOR FLOOD DAMAGE MITITGATION IN MILAPOD

- IFB-TACO-KFOR-19-094 REFURBISHMENT & REORGANISING OF MAN GATE AT CNH

Dyshojmë se në këto kontrata është falsifikuar nënshkrimi i personit përgjegjës se KFOR-it konkretisht Znj. REGINE DOUGLAS ku ne të gjitha kontratat nënshkrimi i saj është i përmasave identike pa dallim fare. Ne e kemi bere krahasimin me matje te sakta te nënshkrimit si dhe ne baze te dukjes vizuale ku nënshkrimin e Znj. DOUGLAS e kemi përshkallëzuar ne përmasën e njëjtë ku dhe e kemi vërejtur përputhshmërinë e të gjitha nënshkrimeve ne të gjitha këto kontrata ku ka rezultuar plotësisht identik

PËRGJIGJEJE NË PRETËNDIMI NR.1

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr.1 të parashtruar nga “Grupit të OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K ankues, mendon se kjo çështje nuk i takon ekspertit shqyrtues për shqyrtim sepse për dhënien e mendimit se nënshkrimi dhe vula është i falsifikuar duhet me qen ekspert i forenzikës,

Njëherit ekspertit shqyrtues konstaton se O.E. ALBOSS SH.P.K – e plotëson kriterin e përcaktuar me njoftimin për

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën 1130/20 e parashtruar nga: Grupi i OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K-Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren” me numër të prokurimit:622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK– “KK-Prizren” e përsëritur

kontrate : Kërkesën 1. "Projektet e natyrës së kontratës të realizuar ne tri vite te shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) vlera minimalë e ti gjitha projekteve te natyrës së Kontratës duhet te jetë jo me vogël se 1.900.000 €" dhe pa i llogaritur këto kontrata per te cilat AK ka dyshime.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar

PRETENDIMI NR.2

Lidhur me pretendimin e Grupit te OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K – ankues se OE "ALBOSS" SH.P.K. i shpallur fitues ne Paramasen e ofruar tek rekapitullimi i punëve te mbindërtimit OE ne fjalë e përdor simbolin e valutës \$,

PËRGJIGJEJE NË PRETENDIMI NR.2

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr.2 të parashtruar nga "Grupit te OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K ankues, duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim si ofertën me çmime Vendimin nr. 880/20 te datës 25.11.2020 te Panelit Shqyrtues i cili vlerëson se ky gabim është një gabim teknik sepse valutën per çmimin per njësi e ka te dhënë ne valutën e përcaktuara me dosjen e tenderit ne baze te se cilës behet pagesa. Prandaj bazuar ne dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim është i pa bazuar. Eksperti shqyrtues se sqaron se bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar

PRETENDIMI NR.3

Lidhur me pretendimin e Grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K – ankues se Grupit te OE Nuk e plotëson Kërkesën "Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së Kontratës duhet të jetë jo më vogël se 1.900.000 €

OE në fjalë arrin një total të kontratave me vlerë: 1.591.187,39 € Kjo pasi që disa nga kontratat nuk janë të natyrës së njëjtë:

- 1.Ndërtimi i Terenit sportive ne Lagjen 11 Marsi në Prizren, me nr. të prokurimit 622-18-096-521.- 119,567.70 €
- 2.Krijimi i ambientit në Kabash dhe Korish si destinacion turistik, me nr. të prokurimit 622-18-117-521. - 71,087.00 €
- 3.Demolimi i sipërfaqes Charlie në kampin fushor Prizren. -- 444,695.00 €

Ndërsa tek Lista e Kontratave, Kontratat me numër 30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43. janë më të vjetra se 3 vite.

PËRGJIGJEJE NË PRETENDIMIN NR. 2

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr.2 të parashtruar nga "Grupit te OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K ankues, duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim, pretendimit te OE Ankues, Vendimin nr. 880/20 te datës 25.11.2020 te Panelit Shqyrtues i cili konsideron se autoriteti kontraktues duhet te kërkoj sqarime shtese, te vlerësoj dhe vërtetoj nëse keto kontrata janë te natyrës se ngjashme konforme kërkesës se dosjes se tenderit. Eksperti shqyrtues se sqaron se bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë

të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së

AK-ja me datën 19.12.2020 ka bere kërkesën për sqarim të tenderit (sjellja e dëshmime) OE "ALBOSS" SH.P.K. të cilën po e japim me poshtë:



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit (sjellja dëshmiye)

Prizren : 09/12/2020

Kontraktuesi :Komuna e Prizrenit, Rr. Remzi ademaj, Pa

Tenderuesi : "ALBOSS" SH.P.K., Grejtkos, Suhareke, 23000, GREJKOVÇ

Nr. i prokurimit:	622	2	0	0	4	5	5	1	1
--------------------------	------------	----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------

Titulli: Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren

I/e nderuar(a):

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-063 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

1. Të na silleni këto dokumenta :

1. Të na sillni të gjitha kontratat dhe referencat (pranimit teknik) të paraqitura në listën e kontratave dhe referencave.

2. Ndërtimi i objektit të radiologjisë -Faza parë të na sillni transaksionet bankare për këtë kontratë në mesë të I.SEFERIT dhe Albosist.

Dokumentat e kërkuara duhet të dërgohen (dorëzohen fizikisht në zyrën e prokurimit) ose në e-mail : prokurimipz@hotmail.com dhe e- Prokurimi deri me 15/12/2020 ora 16 00

Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht,

Me respekt,

Isa Osmanaj

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Nënshkrimi]

OE sipas kërkesës se AK-se i dorëzon dëshmitë e kërkuara

Ekspteri shqyrtues pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni si dhe listën e dorëzuar, kontratat si dhe referencat apo pranimin teknik përfundimtar të dorëzuara nga OE, dhe për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore. në tabelën e projekteve tek vërejtjet kam dhënë vlerësimin për secilën kontratë veç e veç dhe në bazë të saj konstatoj se OE Grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K gjatë periudhës tre vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për Kontrate ka realizuar punime të ngjashme në vlerë prej 2,152,0057 euro dhe e plotëson kriterin e kërkuar e cila është në shumën prej 1,900,000,00 euro

Me poshtë po japim listën e projekteve të kërkuar dhe të klasifikuara sipas natyrës së ndërtimit.

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën 1130/20 e parashtruar nga: Grupi i OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K- Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit:622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK- "KK-Prizren" e përsëritur

Tabela e projekteve të realizuara gjatë tri viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë

Nr.	Emri i projektit	Numri i Prokurimit	Autoriteti Kontraktues	çmimi kontraktues	Nënshkrimi i Kontratës	kontrata	Reference, ose Pranimi Teknik Përfundimtar - data	Projekte te Natyrës se kontratës	Vërejtjeje
1	Ndërtimi i Memorialit të Komandant Drinit në Prizren	622-19-123-521	Komuna e Prizrenit		27.11.2019	PO	JO	PO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
2	Ndërtimi i urës që lidhë fshatin Smaq me komunën e Mamushës	622-19-186-521	Komuna e Prizrenit		13.01.2020	PO	20.05.2020	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar sepse nuk është objekt i ndërtimit te lartë – natyrës se njëjtë
3	Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e objekteve te banimit kolektiv në Prizren	622-19-187-521	Komuna e Prizrenit	235,141.50	21.11.2019	PO	15.07.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
4	Improvement of APOD Main Gate	IFB-TACO-KFOR-19-103	Headquarters Kosovo Force - KFOR		25.11.2019	PO	JO	PO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
5	Ndërtimi i objektit për trajnime EOD në kazermën e FSK-së në Prizren	217-19-3403-521	Ministria e Mbrojtjes	101,802.20	30.07.2019	PO	17.12.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
6	Refurbishment Works For Flood Damage Mititgation In MIL APOD	IFB-TACO-KFOR-19-093	Headquarters Kosovo Force - KFOR		23.07.2019	PO	JO	PO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
7	Refurbishment & Reorganising Of Main Gate at CHN	IFB-TACO-KFOR-19-094	Headquarters Kosovo Force - KFOR		23.07.2019	PO	JO	PO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
8	Enhance Security of Restricted Zone in MIL APOD (HSG ENG 3525)	40003810	Headquarters Kosovo Force - KFOR		21.03.2019	PO	JO	PO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
9	Punimi i kabineteve ne nën kulmin e shkolles Filllore ne Mushnikove te Prizrenit	622-19-096-521	Komuna e Prizrenit	107,945.38 10,600.00	30.07.2019	PO	14.05.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën 1130/20 e parashtuar nga: Grupi i OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K-Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit:622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK- "KK-Prizren" e përsëritur

10	Ndërtimi i sallës sportive në SHFMU Fadil Hisari në Prizren	622-17-047-521	Komuna e Prizrenit	63,268.00	08.09.2017	PO	21.11.2018	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
11	Restaurimi i Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit	89-9/2019	QRTK-Prizren	38,444.00	18.05.2018	PO	17.12.2018	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
12	Ndërtimi i shkollës në Busavat Kamenicë	208 17 005 51 I	Ministria e Arsimit	241,645.53	21.04.2017	PO	03.12.2019	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
13	a) Gërmimet e dheut, rregullimi i pllakës nga betoni dhe vendosja e drenazhës b) Lidhja e ujit dhe kanalizimit në kontejnerin e ri	BM 1801-02 KOS PRZ	KFOR	61,914.00	06.08.2018	PO	26.08.2018	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
14	Sanimi f Fasadës në objektin e shtabit DEU Einskgt KFOR	1708/B KOS PRZ	KFOR	265,700.20	19.06.2017	PO	30.09.2017	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
15	Rregullimi i rrethojave të terreneve sportive në Prizren	622-19-094-521	Komuna e Prizrenit	19,444.80	19.07.2019	PO	06.05.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
16	Furnizimi me inventar për objektet ekzistuese në Prizren	622-19-166-121	Komuna e Prizrenit	22,825.70	20.11.2019	PO	06.05.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
17	Ndërtimi i terrenit sportiv në lagjen "11 Marsi" në Prizren	622-18-096-521	Komuna e Prizrenit	119,567.70	02.11.2018	PO	12.05.2020	JO	I plotëson kriteret e kërkuar
18	Fasadimi i objekteve të banimit kolektiv në Komunën e Prizrenit	622-18-108-521	Komuna e Prizrenit	54,967.75	06.11.2018	PO	07.12.2018	JO	I plotëson kriteret e kërkuar
19	Krijimi i ambientit në kabash dhe Korishë si destinacion turistik	622-18-117-521	Komuna e Prizrenit	71,087.00	15.11.2018	PO	03.10.2020	JO	
20	Ndërtim i Qëndresë së Mjekësisë Familjare në fshatin Romajë në Komunën e Prizrenit	622-18-6727-521	Komuna e Prizrenit		19.10.2018	PO	JO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
21	Ndërtimi i Aneksit të Radiologjisë faza e (I) parë		I.SEFERI	105,000.00	05.07.2018	PO	24.12.2018	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
22	Punimet ndërtimore dhe zejtare - Ndërtimi i aneksit të objektit të Radiologjisë Faza II*- (Dyte)	70010-19-4719 -5-2-1	Spitali Rajonal-Prizren	187,956.71	16.08.2019	PO	14.05.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën 1130/20 e parashtruar nga: Grupi i OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K& "Renelual Tahiri" SH.P.K-Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit:622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK- "KK-Prizren" e përsëritur

23	Punët zejtare dhe instaluese ne renovimin e reparteve te Emergjencës dhe Internos	70010-19-3175-521	Spitali Rajonal-Prizren	68,851.59	18.07.2019	JO	14.05.2020	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar Kontrata
24	Demolimi i sipërfaqes Charlie ne kampin fushor Prizren, sipas ofertës nga përshkrimi teknik	MB 260-03 KOS PRZ	KFOR	444,695.00	09.06.2018	PO	26.08.2018	JO	I plotëson kriteret e kërkuar
25	Instalimi i Ventilimit dhe Klimatizimit në repartin e Fizioterapisë	70010-18-746-5-2-1	Spitali Rajonal-Prizren		19.04.2018	JO	JO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar Kontrata dhe as referenca apo pranimit teknik përfundimtarë
26	Building of new watchtowers at CFC	IFB-TACO-KFOR-17-097	FILM CITY		28.07.2017	JO	JO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar Kontrata dhe as referenca apo pranimit teknik përfundimtarë
27	Punimi i sipërfaqeve te betonin ne kampin Prizren	BU 1710 KOS PRZ	KFOR		16.07.2017	JO	JO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar Kontrata dhe as referenca apo pranimit teknik përfundimtarë
28	Sanimi i ndërtesës së rojës tek porta 2 e Kampit ushtarak "Camp Prizren"	BU 1712 KOS PRZ	KFOR		14.09.2017	JO	JO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar Kontrata dhe as referenca apo pranimit teknik përfundimtarë
29	Rinovimi i parkingut NSE	BM 1810 KOS PRZ	KFOR		28.09.2018	PO	PO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është objekte i natyrës së njëjtë
Vlera e kontratave te cilat i plotësojnë kriterin e kërkuara me njoftimin për Kontrate: Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve				2,152,005,47					

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezultojn se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar

RETENDIMI NR.4

Lidhur me pretendimin e Grupit të OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K – ankues Për Operatorët Ekonomik të tjerë Autoriteti Kontraktues ka zbatuar ligjin e prokurimit dhe rregulloren duke u mbështetur në nenet dhe në dokumentet që Ata si OE nuk i plotësojnë kushtet dhe nuk janë të përgjegjshëm për realizimin e projektit.

PËRGJIGJEJE NË PRETENDIMIN NR. 4

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr. të parashtruar nga “Grupit të OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K ankues. Vendimin nr. 880/20 të datës 25.11.2020 të Panelit Shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar sepse as njeri nga operatorët ekonomik të cilët janë eliminuar gjatë procesit të Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahimit të Tenderëve nga Autoriteti Kontraktues nuk kanë bërë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP për eliminimin e tyre nga procedurat e mëtejshme

. Eksperti shqyrtues se sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së

Andaj ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues ankesa: Grupit të OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K ankues të merret si e pa bazuar. Andaj dhe rekomandojmë që të anulohet Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi B58 -NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES dhe AK-ja të vazhdojë me procedurat në bazë të LPP-së – me nënshkrimin e kontratës

Raporti i Ekspertizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues	– KOMUNA PRIZREN
Panelit Shqyrtues	– OSHP-së.
OE ankues	– Grupit të OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën 1130/20 e parashtruar nga: Grupi i OE N.P.N “Alfa-Ing” & “BM Group” SH.P.K & “Renelual Tahiri” SH.P.K- Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren” me numër të prokurimit: 622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK- “KK-Prizren” e përsëritur